

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 622-23-9421-5-1-1/C1283

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

G-PROJECT, BESIM SHALA PN, PRIZREN, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara me poshtë:

Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapsoirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, Ndërtimi i rrugës Shuaip Spahiu, projekt dyvjeçar me numër identifikues: 622-23-9421-5-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapsoirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, Ndërtimi i rrugës Shuaip Spahiu, projekt dyvjeçar**

No.	Lot
1	Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapsoirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, Ndërtimi i rrugës Shuaip Spahiu, projekt dyvjeçar

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **578,775.36 €** (pesqind e shtatëdhjetë e tet mijë e shtatqind e shtatëdhjetë e pes euro e tridhjetë e gjasht cent).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	22.11.2023
Vula:	

[Ne rast të kontratave me vlerë të madhe]

Emri:	Z. Shaqir Totaj Kryetar
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	21.11.23
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Genc Besimi
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	24.11.2023
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 622-23-9421-5-1-1/C1283

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 18 muaj kalendarik .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë .dy dit pas hyrjes në fuqi të

		kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 400 ditë pune
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Çelë Lamaj Drejtor në DSHP Menaxheri i Kontratës është: Zenun Tolaj , pozita që mban zyrtari ne momentin e caktimit: Menaxher i Grup i Operatorëve Ekonomik P.M.N. SH.P.K.; N.P.N. UNIVERS- MI ; Instituti I Shkencës Dhe I Teknologjisë Insi SH.P.K.
Parapagimi		Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: e vlerës se kontratës.
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve.
Pagesa shkëputjes së kontratës pas	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periodha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-23-9421-5-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **G-PROJECT, BESIM SHALA PN, 20000, PRIZREN, Kosovë**

E-mail: **gprojectgg@gmail.com**

Personi kontaktues: **Genc Besimi**

Telefoni: **045 666952**

Faxi:

Numri fiskal: **810970716**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-23-9421-5-1-1

Titulli i kontratës: Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapsoirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, Ndërtimi i rrugës Shuaip Spahiu, projekt dyvjeçar

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapsoirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, Ndërtimi i rrugës Shuaip Spahiu, projekt dyvjeçar

3. Çmimi total i tenderit është:

577,775.35 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **120** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

PARAMASA DHE PARALLOGARIA
REHABILITIMI I RRUGËS : "Shuaip Spahiu " NË PRIZREN

Gjatësia L=205m

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
1		1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT				
	1.1	Trasimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike për rrugë , trotuare dhe të gjitha objektet ndimëse.	m'	205.00	2.00	410.00
	1.2	Sigurimi i punishtës nga hyrjet anësore të automjeteve. Sigurimi të bëhet përmes shenjave përkatëse të cilat krijojnë siguri dhe zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sipas kërkesave të investitorit.	m'	205.00	4.00	820.00
	1.3	Krijimi i hapsirave për qarkullim të pa ndërprer të këmbësorëve dhe automjeteve gjatë kohës së zhvillimit të punimeve.	m'	335.00	4.70	1,574.50
	1.4	Prerja vijore e asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta me makineri adekuate.	m'	100.00	7.00	700.00
	1.5	Kontrollimi dhe evdntimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesin të ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujrave fekale si dhe me telefoni. Për të gjitha këto shërbime, kontaktori duhet të ofroj plan detal të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha hargjimet mban përgjegjësin kontraktuse, dmth. investitori nuk merr mbi vete kosto shtesë përveç çmimit që kontraktori oferton në këtë pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që të furnizoi vet institucionet publike dhe lokalet afariste përmes kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmes një kontratë emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i këtij pozicioni.	m'	205.00	28.00	5,740.00
	1.6	Shënjestimi i instalimeve nëntoksore të cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues.	m'	205.00	3.00	615.00
	1.7	Demolimi dhe transporti deri në deponi i kaldermit dhe ruajtja e tij në deponi të siguruar nga investitori për RI-Përdorim të këtij projekti sipas poz. 3.5 , sipas kërkesës së investitorit. Vërejte: Kaldermi duhet të demolohej me kujdes si dhe gjat ngarkimit dhe shkarkimit duhet të ket kujdes që mos të demtohet. Për qdo demtim eventual të tij mbetet në përgjegjësin e kontraktorit. Demolimi të bëhet në prezencën e org.mbiqyres.	m ²	2,220.00	9.50	21,090.00
	1.8	Demolimi dhe transporti deri në deponi i asfaltit, pllakave nga betoni dhe materialeve tjera të ngurta me trashësi dhe dimensionet të ndryshme .	m ²	140.00	5.00	700.00
	1.9	Demolimi i gurëve skajorë ekzistues me dim 18x24 dhe materialeve tjera të ngurta duke përfshir edhe transportin në deponi.	m'	430.00	4.00	1,720.00
	1.10	Demolimi i gurëve skajorë ekzistues me dim 10x20 dhe materialeve tjera të ngurta duke përfshirë edhe transportin.	m'	250.00	4.00	1,000.00

1.11	Demolime dhe transporti deri ne deponi I materialeve të betonit dhe materialeve tjera të ngurta.	m ³	20.00	5.50	110.00
1.12	Germimi I dheut të kategorisë IV-V me makin dhe dorë në raport (90 me 10%) pas heqjes së asfaltit, gurëve në trotuare me thellsi deri - 60cm.	m ³	1,406.00	4.50	6,327.00
1.13	Kompaktimi , rrafshimi dhe planifikimi I bazës pas grryerjes me Mv>40Mn/m2	m ²	2,220.00	1.00	2,220.00
1.14	Egzaminimi i materialeve dhe bazes se rruges para dhe pas vuarjës në vepër të tyre si psh. tamponit , gurit te kalldermi, granitit dhe elementeve tjera te cilat planifikohen per shqyrtim ne kete projekt. <i>Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake lidhur me origjinen e materialit para fillimit të punimeve sipas te gjithave specifikave te shenuara nga pozicionet e veqanta ne baze te emerimit te produkteve.Te gjitha produktet jane me origjine nga shtetet anetare te EU dhe ne asnje menyre nga shtetet tjera. Per te gjitha keto do te kete perkujdesje te veqante nga projektanti dhe ekipi mbikqyres.</i>	p.s	1.00	700.00	700.00
1.15	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	orë	6.00	50.00	300.00
TOTAL PUNËT E DHEUT , DEMOLIMIT :					44,026.50

Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
2.0 PUNËT E TAMPONIT					
2.1	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës se gjeotekstilin në tere siperfaqen e rrugës ku behet pllakosja. Gjeosintetika duhet te jetë 350 g/m ² dhe duhet ti përmbushë të gjitha kërkesat teknike sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj materiali.	m ²	2,340.00	1.20	2,808.00
2.2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e rerës 0-8mm për mbrojtjen e gjeotekstilin me trashësi prej (5-7) cm duke paraparë edhe nivelizimin për shtresat në vazhdim sipas profilit tërthor.	m ³	109.00	17.00	1,853.00
2.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>60MN/m ² prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-100mm me trashësi t=40cm (në gjendje të ngjeshur) si bazë per vendosjen e trupit të rruges në pikat ku kemi jo stabilitet.	m ³	49.00	15.00	735.00
2.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>65MN/m ² prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-63mm me trashësi t=20cm (në gjendje të ngjeshur).	m ³	438.51	16.50	7,235.42
2.5	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>80MN/m ² prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-31.5mm me trashësi t=10 cm në rrugë (në gjendje të ngjeshur).	m ³	219.00	18.00	3,942.00
TOTAL PUNËT E TAMPONIT:					16,573.42

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
	3	3,0 PUNËT E BETONIT DHE PLLAKAVE NGA GURI NATYRORË				
	3.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i pllakës horizontale me trashësi t=15cm nga Beton Armeja me klasë C25/30 i prodhuar në fabrikë e armuar me dy shtresa armatur rrjetë (Q335, Ø8mm/15cm) me kualitet S500B, në dy drejtime (Pas betonimit dhe ngurtësimit bëhet prerja tërthore në qdo 6.0m distancë). Furnizimi me çimento portland - sipas standardit EN 197-1:2011 • Furnizimi me rrërë - sipas standardit BS EN 998-1 • Furnizimi me aditiv varësisht nga mbikqyrësi, • Përzjarja - sipas standardit DIN EN 13813	m ²	2,240.00	36.00	80,640.00
	3.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtreses Stabilizim me Çimento me trashësi t=5-7cm në gjendje të ngjeshur me këto karakteristika : SC, b=28 ditë, 3-6mP, agregati guri i thyer gëlqerorë, rrërë 0-8mm.	m ³	148.00	99.00	14,652.00
	3.5	Furnizimi, transporti dhe vuarja në vepër e gurëve natyral ekzistues të cilët do të ripërdoren pas demolimit, sipas poz. 1.7. M ²	m ²	800.00	45.00	36,000.00
	3.6	Furnizimi, transporti dhe vuarja në vepër e gurëve natyral (kalldermi) të ri me karakteristika dhe dimensione të njëjta sikurse ekzistueset. Llogaritja bëhet me matje të sipërfaqes në neto - m ²	m ²	1,400.00	118.00	165,200.00
3	3.7	Furnizimi i materialit, transporti dhe punimi i fugave të gurve natyral (kalldermi) me thellsi: 8-10cm, trashësi 10mm, ky gjysma mbushet me rrërë ndërsa gjysma e epërme me llaç çimentoje (Çimento e hirt , granit i hirt i thyer me fraksion 2/4mm dhe rrëzina e poliuretanit 1.5kg/m ²), përzjarja - sipas standardit BS EN 1341:2012 duke përfshirë edhe pastrimin e pllakave pas vendosjes së fugës. Llogaritja bëhet me matje të sipërfaqes në bruto (siperfaqja në neto e shtruar me gur natyral) - m ²	m ²	2,220.00	4.50	9,990.00
	3.8	Furnizimi me material, punimi i gureve natyral me tashësi t=5cm gjeresi jo me te vogel se b=0.60cm. Ne cmim te kalkulohet montimi me llaq çimentoje si dhe fugimi me beton te rrjedheshem. Gjithashtu demolimi i gureve ekzistues si dhe bartja ne deponin me te afert legale. Ne qmim te kalkulohet edhe nivelizimi sipas nevojës me beton i murit te Lumbardhit para vendosjes se gurit natyral. Marrja e masave ne vend. Verejteje: Ne te dy anet a murit pikorja e gurit duhet te dal =4cm jasht murit.	m'	400.54	74.00	29,639.96
	3.9	Furnizimi me preparate pastrimi si dhe gerryerja dhe pastrimi i murit te Lume Bardhit me lartesi jo me te madhe se h=0.70cm me preparate dhe uje me presion si dhe pastrimi adekuat dhe hjekja e barishtave. Mbeturinat te transportohen ne deponin me te afert legale.	m'	400.54	2.00	801.08
	3.10	Furnizimi me material te nevojshem dhe Nivelizimi i gjitha pusetave egzistuese me niveleten e rrugës së projektuar sipas normave dhe standarteve në fuqi deri në aprovim nga organi mbikqyrës.	copë	12.00	80.00	960.00
						337,883.04

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		4,0 PUNËT TË NDRYSHME				
4	4.1	Furnizimi, bartja dhe vendosja e shtyllave elektrike automatike deri në funksionalizimin e tyre si produkt, për ndalim të komunikacionit në kohë të caktuar sipas detaleve në projekt, përzgjedhja e tyre të bëhet në konsultim me organin mbikqyrës.	copë	7.00	500.00	3,500.00 ✓
	4.3	Furnizimi, transporti dhe instalimi i ulësës me dim: 81cm' x 160 cm' . (sipas detaleve në projekt). Uë-132-03-52-XXXX me karakteristika të njehta. • Pjesa e sipërme për ulje 81cm x 60 cm' e përbërë nga listella RESYSTA® (është një përbërje e prodhuar ekologjikisht me fibra natyrale me pamje druri) me dim. 2 x 140mm' x 20mm' dhe 6 x 20mm' x 70mm'. • Konstruksioni i cili mbështjellët nga listellat për ulje RESYSTA® është nga metali CORTEN, të gjitha vidat jepen nga pjesa e padukshme - ana e poshtme e ulësës, • Këmbët e ulësës janë pllaka metali Corten me trashësi së paku 12 mm' të cilat vendoset në dy skajet e saj, e cila përbëhet nga pjesa mbi tokë 475 mm' x 490 mm' x 12 mm' dhe pjesa nëntokë për ankerim min. 300 mm' x 490 mm' x 12 mm' e cila është e njëpjesëshme, Në çmim përfshihet: • Punët përgatitore, • Furnizimi dhe transporti • Bartja dhe vendosja në vepër sipas projektit, • Të gjitha kostot dhe aktivitetet e tjera të nevojshme për vuarje në vepër si dhe mirëmbajtjen e saj. Llogaritja bëhet me matje të sasisë në neto - copë Paraprakisht punekryesi duhet ta prezantoj një ulësë për aprovim.	copë	26.00	290.00	7,540.00 ✓
	4.4	Prerja, Largimi i drunjëve ekzistues sipas . Drunjte që duhet të largohen janë të parqitur në projekt dhe në konstatim me numra rendorë. Nr. 2,3,5,8,9,12,16,18,19,20,24,27,29,31,32,33,38,40,41,45 . Materiali i demoluar të transportohet në deponi legale. Në çmim të kalkulohet edhe hapjet e nevojshme perimetrike sipas nevojës për asgjësimin e rrenjeve të pemeve.	copë	20.00	25.00	500.00 ✓
	4.5	Furnizimi me material, punimi i mbrojtësve të trungut të pemeve në formë katrorë me dim: 75/75cm dhe lartësi h=1.50. Mbeshtjellësi të punohet me shufra qeliku me tre horizontale në formë katrore shufër metalike me dim 2x2cm dhe t=2mm. Këndet të jenë në formë harkore. Vertikalet dim 3x1cm t=2mm , cdo 12cm distanc njëra prej tjetres. Në çmim të kalkulohet lyerja një shtresë ngjyre antikoreduese dhe dy shtresa ngjyre metali me nuance antracid ose sipas përzgjedhjes, si dhe materiali i imet për ankerim . Për detaje referojuni projektit.	cope	26.00	100.00	2,600.00 ✓
	4.6	Furnizimi me material, punimi dhe vendosja e shportave nga materiali i Gurit natyral dhe Qelikut sipas specifikave: Të punohet kufizimi i brendeshëm i shportës nga guri natyral i gdhendur me dorë, me dim: 50/50/70cm si dhe gravirimi në dy ballore me emblemen e komunes së Prizrenit si dhe paterna e konceptit. Të bëhet kufizimi metalik me pllake qeliku me trashësi jo më e vogël se 1mm. Në çmim të kalkulohet mekanizmi për mundësinë e hapjes së shportave dhe gjithashtu në anën e brendeshme të shportës të punohet shporta metalike nga metali. Për pjesët metalike të lyhen me një shtresë antikoreduese dhe dy shtresa ngjyre pigment antracid ose sipas përzgjedhjes. Për detaje referojuni projektit.	cope	4.00	150.00	600.00 ✓
	4.7	Shtegu për të Verber. Furnizimi me material, vendosja e pllakave taktile me fluska për të verber me dim: 400x400x65mm. Ngjyre hiri e përafërt me ngjyrë të kalldermi. Në çmim të kalkulohet të gjitha shtresat zhavorike për funksionalizim si dhe fugimi i nevojshëm.	m'	200.00	22.00	4,400.00 ✓

4.8	Dera per dalje tek Lumi: Furnizmi me material, punimi i deres nga Qeliku me dim: 65/80cm. Kornize 5/5cm krahu u deres me kornize me dim te shufrave 5/5cm t=2mm. Panel dekorativ metalik i prodhuar me makineri CNC modeli dhe dizajni sipas projektit. Ne qmim te kalkulohet Doreza Inox , bravë kualitativ prodhim EU , dhe cilinder kualitativ me tre qelesa. Dera te lyhet me nje shtres antikoriduese dhe dy shtresa ngjyre metalike pigment antracid ose sipas perzgjedhjes. Vereiteje: Paraprkisht masat mirren ne vend.	cope	2.00	175.00	350.00
4.9	Shkallet metalike per dalje ne Lum: Furnizmi me material, punimi dhe montimi i shkalleve te Qelikut sipas specifikave: Profilet metalike vertikale (korniza) me dim 8/5cm. , horizontalet (shkeleset) 8/4cm. Ne qmim te kalkulohet edhe dorembajtesi ne te dy anet e shkalleve me shufer metalike ne forme harkore e cila eshte me gjate L=1.05m se shkallet si dhe distanca nga shkeleset te jet 18cm. . Ramja e shkalleve 80°. Ne qemim te kalkulohej nje gjithe materiali lidhes , ankerues si dhe punimi i pushimores metalike me dim: 80/60cm sipas projektit. Komplet shkallet para montimit te Plastifikohen pasi qe kan kontakt me ujin. Paraprkisht marrja e masave ne vend dhe aprovimi i detajeve nga personi pergjegjes.	m'	4.10	175.00	717.50
4.10	Paneli Informativ: Furnizmi me material dhe punimi i panelit informativ sipas specifikave: Pllake metalike te galvanizuar t=1.5mm. (llamarine e galvanizuar) me prerje llaserike CNC e stilizuar me konceptin e projektit. Ne pjesen e panelit informative te behet ne kordinim me materialin e polikarbonit. Ne qmim te kalkulohet edhe konstruksioni i brendeshem i qelikut. Mundesia per ankerim ne toke . DIM: 122/23/36cm Per detaje te tjera referojuni projektit. Ne qmim te parashihet edhe instalimet elektrike te nevojshme.	cope	1.00	500.00	500.00
4.11	Furnizimi dhe Mbjellja e xhelbrimit te larte - drunjeve te rinje per zevedesimin e atyre te larguar paraprkisht. Drunjet e ri duhet te jene te llojit " Bli " me lartesi jo me te vogel se 3.00 m dhe diametrin e trupit jo me te vogel se 20cm. Operatori duhet te garantoj 1 vit ne raste se thahen ato ti zevendesoj me drunje Bliri te ri.	cope	11.00	120.00	1,320.00
TOTALI PUNËT E NDRYSHME				22,027.50	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA REHABILITIMI I RRUGËS : "SHUAIP SPAHIU NË PRIZREN		
Gjatësia L=334.07m		
1.0	PUNËT E DHEUT	44,026.50
2.0	PUNËT E TAMPONII	16,573.42
3.0	PUNËT E KALLDERMIT DHE BETONIT	337,883.04
4.0	PUNËT TË NDRYSHME	22,027.50
Totali:		420,510.46 €

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN ATMOSFERIK

• Rr. "SHUAIP SPAHIU" - PRIZREN

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT				
	1.1	Trasimi-piketimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike sipas projektit, i cili shërben për përcjelljen e punimeve, gjatë ekzekutimit të punimeve të kanalizimit.	m'	298	1.4	417.2
	1.2	Inqizimi, i rrjetit sipas gjendjes së ekzekutuar të kanalizimit (pas ekzekutimit të rrjetit të kanalizimit). Inqizimi gjeodezik duhet të bëhet nga kompanija e licensuar për këtë lloj aktiviteti. Materiali duhet të dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.	m'	298	1.4	417.2
	1.3	Pastrimi i terenit, demolimi i materialeve tjera të ngurta, pustave ekzistuese, gypave të infrastruktures nëntokësore, rrethojave etj., në pjesën ku do të zhvillohet traseja e kanalizimit si dhe largimi i ktyre materialeve deri në deponi (aty ku përcakton organi mbikëqyres)	paushall /m'	298	4	1192
	1.4	Prerja e asfaltit dhe transporti i tijë deri në deponinë ku e cakton organi mbikëqyres, me trashësi t=11cm, si dhe Furnizimi me material dhe rishtrimi i rruges me asfalt me trashësinë e njejtë. Në qmim të parashihen të gjitha pozicionet tjera të nevojshme paraprake deri në shtruarie të asfaltit.	m2	190	10	1900
	1.5	Kthimi në gjendjen fillestare të rruges, pas realizimit të kanalizimit atmosferik, përfshirë shtresat e zhavorit dhe asfaltit për pjesën e kanalizimit që ndodhet jashtë zones së trajtuar me kallderm.	m2	140	18	2520
	1.6	Realizimi i lidhjeve të gypave të kanalizimit atmosferik nga objektet ekzistuese në rrjetin e ri të kanalizimit, duke përfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme për një funksionim të plotë.	copë	11	75	825
	1.7	Realizimi i lidhjes së gypit të projektuar në pusëtën ekzistues duke përfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha furnizime të material për pozicionet e nevojshme për një funksionim të plotë.	copë	1	110	110

	Gërmimi me dorë , makinë, dhe transporti deri në deponi i dheut , me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV, V dhe VI-të. Tehet e kanaleve duhet të gërmohën në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjahet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'.				
1.8	- Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në H= 3,2m' , kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i gypit.				
a	gërmimi me makinë 90%	m ³	835.0	3.5	2922.5
b	gërmimi me dorë 10%	m ³	103.0	8.0	824.0
1.9	Mbrojtja e gropes ndërtimore në tërë gjatësin e kanalit. Montimi dhe demontimi i mbrojtësve pas përfundimit të punimeve.	m'	298	5	1490
110	Zgjerimi dhe thellimi në vendet e puseta. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol. 19 puseta	m ³	22	4.0	88
111	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m2 të sipërfaqes reale të planifikuar.	m ²	165	1.1	181.5
112	Furnizimi, shtrirja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=4-8mm, sipas detajit në projekt.	m ³	243	16.5	4009.5
113	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresën e zhavorit standart për rrjeta të kanalizimit atmosferik.	m'	298	0.8	238.4
114	Furnizimi, transporti , Mbushja dhe mbulimi i kanalit me material nga guri gelqeror tampon 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa max 20-30 cm me Mv>90Mn/m2.	m ³	755	13.5	10192.5
115	Largimi i dheut të tepert të germuar nga punishtja deri në vendin ku e cakton organi mbikqyrës i projektit.	m ³	880	2.2	1936
116	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	8	20	160
TOTAL PUNËT E DHEUT :					29,423.80

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
2		2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME				
	2.1	Furnizimi me material dhe punë për punimin e fundit të pusëtës kontrolluese me C-20/25 (për punimin e pllakes nga betoni dhe kinetave sipas detalit në projekt). Trashësia (lartësia) mesatare e fundit është 20cm. Këto funde shërbejnë si bazë për vendosjen e unazave të gatshme montuese nga betoni Ø1000 mm, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.				
	a	për puseta rrugore	m³	6.5	120	780
	2.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për puseten e ujmbledhësave me dim: 60*40cm.	copë	8	55	440
	2.3	Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit armuar me shpuarjen e hapsirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lidhja e gypave me llaq çimentoje. Për secilën pusetë është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të të cilit montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusëtës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante:				
	a	Unaza në formë të konit	copë	11	60	660
	b	Me profil konstant	m'	36	65	2340
					TOTALI	4,220.00
Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
3		3,0 PUNËT METAL PUNUESE				
	3.1	Furnizimi transporti montimi i kapakëve prej materialit Cor-ten (sipas detalit në projekt), DN-600 mm, konform Standardit EN124, klasa D400 kN. pesha e kapakut T=40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurores prej betonarmesë C-25/30. Përzgjedhja dhe aprovimi i materialit të bëhet me aprovimin e projektuesit dhe mbikqyrësit të projektit.				
	a	për puseta rrugore	copë	11	145	1595
	3.2	Shkallët në puseta Furnizimi, transporti dhe ndërtim montimi i shkallëve të hekurta Ø 20 mm në murin e pusëtës. Shkallat të vendndërtohen në çdo 30 cm me ngjyrosje kundër korozionit. Logaritja me copë.				
	a	për puseta rrugore	copë	80	10	800
	3.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i grilave të pusetave për ujëbledhësat prej materialit Cor-ten për pesha të rënda (sipas detalit në projekt). Në çmim të llogarohet: betonimi i kurores prej beton armesë C-25/30. Përzgjedhja dhe aprovimi i materialit të bëhet me aprovimin e projektuesit dhe mbikqyrësit të projektit.	copë	9.0	120.0	1080.0
					TOTALI	3,475.00
		4,0 PUNËT E MONTUESE				

4	4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar të kanalizimit PE SN8, në bazë të standardit EN 13476-3 dhe ISO 9969, duke përfshirë edhe lidhjen e gypave me puseten e kanalizimit, duke mbyllur zbrazdësitat me llaq qimento, në mënyrë që të mos ketë infiltrime të ujrave anësore si dhe ujrave nëntokësore në puseta. Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet.				
	a	DN- 160 mm	m'	0	0	0.00
	b	DN- 200 mm	m'	0	0.0	0.00
	c	për kolektorë DN- 400 mm	m'	298	22	6,556.00
	d	për kolektorë DN- 800 mm	m'	0	0	0.00
					TOTALI	6,556.00

5	5.0	TESTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT ATMOSFERIK				
	5.1	Testimi i rrjetit të kanalizimit ATMOSFERIK sipas normave teknike, nga kompanija e çertifikuar për këtë lloj aktiviteti, si dhe përpilimi i raportit me shkrim për këtë testim. Raporti i testimit duhet të dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.	m'	298	1.1	327.80
					TOTALI	327.80

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN ATMOSFERIK		
• Rr. "Shuaip Spahiu" - Prizren		
1.0	PUNËT E DHEUT	29,423.80
2.0	PUNËT E BETONIT DHE BETON-ARME	4,220.00
3.0	PUNËT METAL-PUNUESE	3,475.00
4.0	PUNËT MONTUESE	6,556.00
5.0	TESTIMI I RRJETIT	327.80
	Totali:	44,002.60 €

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN FEKAL

• Rr. "SHUAIP SPAHIU" - PRIZREN

Vërejtje: Para seciles porosi të materialeve, për secilin material të përshkruar në paramasë, menaxherit të kontratës ose org.mbiqyres duhet ti ofrohen për aprovim Mostrat dhe Dokumentacionet e nevojshme (si psh. Çertifikatat e kualitetit, katalogjet etj.)

